REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
PRANUAR NË:
PRIMLJENO DANA: 07.10.2026
NJËSIA JEDINICA | NR. KLASIFIKIMIT | NR. LËNDËS NR. PREDMETA | SHTOJCA PRILOG
03 | MM/01-5149

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr:_____
Datë: _____

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë,neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të punës

Tre (3) Mjek/e Përgjithëshëm në QKMF-Lipjan në Njësin e Urgjences

I punësuari do të kryej këto detyra të punës:

1. **Vlerësimi i Gjendjes Shëndetësore të Pacientëve**

- Pranon pacientët dhe bën ekzaminimin klinik fillestar.
- Vlerëson urgjencën e situatës dhe përgatit planin e menjëhershëm të trajtimit.
- Përdor sistemin e triazhimit për të kategorizuar rastet sipas urgjencës.

2. **Trajtimi i Rasteve Urgjente**
- Kryen ndërhyrje mjekësore të menjëhershme për stabilizimin e gjendjes.
- Jep trajtime farmakologjike, kryen injeksione, infuzione dhe procedura të tjera të nevojshme.
- Kordinon me infermierët për zbatimin e kujdesit mjekësor.

3. **Dokumentimi i Ndërhyrjeve Mjekësore**

- Plotëson dokumentacionin mjekësor të çdo pacienti (kartela, formularë, sistem elektronik).
- Regjistron të dhënat për diagnozën, terapinë, gjendjen dhe rekomandimet për trajtim të mëtejshëm.

4. **Vendimmarrje Klinike për Transferime**

- Merr vendime për referim ose transferim në njësi të specializuara kur është e nevojshme.
- Koordinon me shërbimin e autoambulancës dhe njësitë pritëse për sigurinë e pacientit gjatë transportit.

5. **Pjesëmarrje në Turne dhe Dorëzim-Pranim**

- Paraqitet në kohë për fillimin e turnit dhe merr informacion nga turni paraprak.
- Jep informacion të plotë për pacientët në dorëzim-pranimin e turnit.

6. **Zbatimi i Protokolleve dhe Procedurave**

- Zbaton protokollet mjekësore dhe udhëzimet e miratuara nga institucioni dhe autoritetet shëndetësore.
- Respekton rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së pacientit.

7. **Sjellje Profesionale dhe Etike**

- Bashkëpunon ngushtë me ekipin mjekësor dhe ndihmës për garantimin e shërbimit cilësor.
- Respekton konfidencialitetin e të dhënave shëndetësore të pacientëve.
- Vepron me profesionalizëm, etikë dhe durim në situata të vështira ose stresuese.

8. **Pjesëmarrje në Trajnime dhe Përmirësim të Vazhdueshëm**

- Merr pjesë në trajnime të organizuara nga institucioni për emergjencën mjekësore dhe ndihmën e parë.

Kushtet dhe kriteret për Mjek të Përgjithshëm:

- Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës (me afat)
- Certifikata Shëndetësore (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Letërnjoftimi kopje. (me afat)

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë zotësi të plotë veprimit,sipas,legjistlacionit në fuqi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik(vërtetimi nga punëdhensi).

Paga mujore për Mjek të Përgjithshëm:

Grupi H klasa H10 Koeficienti:8.4
Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar
Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:
Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data **07.10/2026** deri **05.11/2026** që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:
Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.
Kandidatet të cilet kanë përfunduar studimet jashtë Republikes së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur(nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.
Vërejtje:
Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës https//kk.rks-gov.net/lipjan dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini